



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 423/5 Prot.

Tiranë, më 28.09.2020

**V E N D I M**  
**Nr.96 dt. 28.09.2020**

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 65, DATË 15.07.2020, TË  
KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL”**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

**KONSTATOVA SE:**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, si dhe të detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2018”, ka realizuar procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, përfshirë institucionin e Bashkisë Himarë.

Në kuadër të procesit të verifikimit, Komisioneri ka kërkuar informacion nga Bashkia Himarë, e cila ka raportuar nëpërmjet shkresës nr. 1420/1 prot., datë 01.06.2020, se punonjësi \*\*\*\*\* me detyrë “Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës”, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 08.01.2020.

Mbi këtë bazë, në zbatim të dispozitës ligjore të parashikuar nga germa c), e nenit 65, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Komisioneri, me Vendimin Paralajmërues nr. 65, datë 15.07.2020, ka vendosur:

1. “Të kërkoj nga Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Himarë, marrjen e masave të menjëhershme për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, duke përfunduar marrëdhënien në shërbimin

civil për shkak të ligjit, për punonjësin \*\*\*\*\* në pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës”.

2. Pozicioni respektiv i punës të shpallet menjëherë pozicion i lirë dhe të fillojë procedura për plotësimin e tij sipas kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil.
3. Kryerja e veprimeve të mësipërme, duhet të bëhet brenda 7 ditëve nga marrja dijani për këtë vendim...”

Në vijim të zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin Paralajmërues nr. 65, datë 15.07.2020, “Mbi paralajmërimin e institucionit Bashkia Himarë, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”, të Komisionerit, institucioni i Bashkisë Himarë përmes shkresës së dërguar me nr. 2196/1 prot., datë 21.07.2020, me objekt: “Kthim përgjigje shkresës me nr.423/3prot. datë 15.07.2020”, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 423/4 prot., datë 24.07.2020, ka sqaruar se Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse ka shpallur të lirë pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës” dhe ka kërkuar shtyrjen e afatit të ndërprerjes së marrëdhënies së punësimit për punonjësin e përmendur në vendimin paralajmërues, për shkak të mungesës të interesit dhe kërkesave për punësim të specialistëve në fushën përkatëse.

Në të njëjtën kohë, në shkresën e mësipërme është argumentuar domosdoshmëria e funksionimit të pandërprerë të këtij pozicioni pune, për shkak se në Bashkinë Himarë në këtë periudhë është duke u kryer procesi i regjistrimit fillestar sistematik i pronave në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Duke qenë se pozicioni i Drejtorit të Mbrojtjes dhe Menaxhimit të Tokës, Pyjeve dhe Kullotave është vakant që prej vitit 2019, ndërprerja nga detyra e punonjësimit \*\*\*\*\* në pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës” do të shkaktonte mosfunksionim të kësaj drejtorie.

Në analizë të sa më lart kur, ndërprerja e menjëhershme e marrëdhënies së punës për punonjësin \*\*\*\*\* do të sillte pengesa në realizimin e projekteve si dhe do të krijonte pengesa në ecurinë normale të punës së institucionit të Bashkisë Himarë, vlerësoj se, kërkesa për shtyrjen e afatit për ekzekutimin e Vendimit Paralajmërues nr. 65, datë 15.07.2020, “Mbi paralajmërimin e institucionit Bashkia Himarë, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”, të Komisionerit, nga ana e institucionit Bashkia Himarë është e drejtë.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, kreu IV “Rishikimi”, nenet 144, 145 dhe 146, si dhe Rregulloren, “Mbi

*procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

**VENDOSA:**

1. Të ndryshoj pikën 3, të Vendimit nr. 65, datë 15.07.2020, me përmbajtje si më poshtë:

Të vijojë marrëdhënia në shërbimin civil për punonjësën \*\*\*\*\* me detyrë “Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës”, në Bashkinë Himarë, deri në përfundimin e procedurës së rekrutimit për plotësimin e këtij pozicioni pune.

2. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Himarë dhe Njësia Përgjegjëse.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**